



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2023:157005

Datë: 20.03.2024

Numri i dokumentit: 05475200

**P.nr.369/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, në përbërje prej gjyqtarit të vetëm gjykues Avdirrahman Gashi, bashkëpunëtores profesionale Gentiana Dakaj, në çështjen penale ndaj të pandehurve Z. B. nga fsh. S. K. L., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me pikën 1.4 të KPRK-së, F. B. nga fsh. S.K. L., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me pikën 1.4 të KPRK-së, P. B. nga fsh.S. K.L., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Jusuf Bytyqi av. nga Lipjani, për shkak të veprave penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me pikën 1.4 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe A. B. nga fsh. S. K. L., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Afrim Tasholli av. nga Lipjani, për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me pikën 1.4 të KPRK-së, të cilët i akuzon PTH në Prishtinë, me aktakuzën saj PP.II.nr.4503/23 të dt.26.07.2023, në shqyrtimin fillestar, publik, të mbajtur me datën 12.03.2024, në prani të prokurorit të shtetit Besnik Jakupi, të pandehurve, mbrojtësit Jusuf Bytyqi av. nga Lipjani dhe Afrim Tasholli av. në Lipjan dhe në mungesë të dëmtuarës M. T. nga fsh. S. K.L., në po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

Ndaj të pandehurve:

**Z. B.**, i lindur me datë ... në Sl.-L., ku edhe jeton, nga i ati Xh. dhe nëna Z.e gjinisë, A., me numër persoanl ..., i martuar, i gjendje së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qënduar në arrest shtëpiak nga data 18.07.2023 deri me 03.08.2023.

**F. B.**, i lindur me datë ... në S.-L., ku edhe jeton, nga i ati Xh. dhe nëna Z. e gjinisë, A., me numër persoanl ..., i martuar, i gjendje së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qënduar në arrest shtëpiak nga data 18.07.2023 deri me 03.08.2023.

**P. B.**, i lindur me datë ... në S.-L., ku edhe jeton, nga i ati F. dhe nëna B. e gjinisë, S., me numër persoanl ..., i martuar, i gjendje së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, ka qënduar në arrest shtëpiak nga data 18.07.2023 deri me 03.08.2023.

**A. B.**, i lindur me datë ... në S.-L., ku edhe jeton, nga i ati F. dhe nëna B. e gjinisë, Sahiti, me numër persoanl ..., i martuar, i gjendje së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

**J A N Ë F A J T O R**

Sepse:  
**I pandehuri Z. B.**

I.Me datë 18.07.2023, rreth orës 08:45, në fshatin S., Komuna e Lipjanit pas një mosmarrëveshje të mëhershme pronësorë ishin përfshirë në një përleshje fizike me tani të pandehurit F. B. dhe P. B. në atë mënyrë që i pandehuri Z. së bashku me bashkëshorten M. dhe djalin e mitur V. B. kishin shkuar në oborrit e shtëpisë së të pandehurit F. B. dhe aty pas një bisede kishte filluar një përleshje fizike dhe i pandehuri Z. duke e përdorur një mjetë të fortë e të përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve trupore (shkop i drurit), e kishte goditur të pandehurit P. dhe A. B., ashtu që të pandehurit P. i shkaktuar gërvishje në regjionin e mbi gjurit të djathtë dhe regjionin e gishtit të vogël të dorës së majtë ku si të tilla kualifikohen lëndime të lehta me pasoja të përkohshme për shëndetin ndërsa të pandehurit A. B. i kishte shkaktuar gërvishtje dhe gjakderdhje nën lëkurorë në regjionin e djathtë të kraharorit po ashtu sit ë tilla kualifikohen lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

-Me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Lëndim i Lehtë Trupor nga neni 185 paragrafi 2 lidhur me pikën 1.4 të KPRK-ës.

### **I pandehuri F. B., P. B. dhe A. B.**

II. Me datë 18.07.2023, rreth orës 08:45, në fshatin S., Komuna e L. pas një mosmarrëveshje të mëhershme pronësorë të pandehurit ishin përfshirë në një përleshje fizike me tani të pandehurit Z. B. në atë mënyrë që të pandehurit në përleshje e sipër e kishin sulmuar fizikisht të dëmtuarën M. T. duke i shkaktuar gërvishje të shumëfishta në regjionin e indeve të buta të abdomenit dhe si të tilla kualifikohen lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, po ashtu i pandehuri Z. B. për shkak të goditjeve ka pësuar enjteje në regjionin e parakrahut ku si të tilla kualifikohen lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.-

-Me këtë të pandehurit secili veç e veç kanë kryer veprën penale Lëndim i Lehtë Trupor nga neni 185 paragrafi 1 lidhur pikën 1.4 të KPRK-ës.

### **I pandehuri P. B.**

III. Prej datës së pa vërtetuar e deri me datën 18.07.2023 i pandehuri në kundërshtim me ligjin për armët, ka mbajtur pa autorizim armën e tipit Pistolet me numër serik ..., një karikator i zbrazët dhe 5 fishek e në kundërshtim më ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, në atë mënyrë që derisa policia e Kosovës kishin shkuar në fshatin S., Komuna e L. lidhur me konfliktin që kishte ndodhur dhe me rastin e kontrolles kanë gjetur dhe sekuestruar armën.

-Me këtë i pandehuri ka kryer veprën penale Mbajtja në Pronësi, Kontroll ose Posedim të pa autorizuar të Armëve nga neni 366 paragrafi 1 i KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të dispozitave të lartëcekura si dhe dispozitave të neneve 1, 2, 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, dhe nenit 185 paragrafi 1 lidhur me pikën 1.4, nenit 185 paragrafi 2 lidhur me pikën 1.4 dhe nenit 366 paragrafi 1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të pandehurve iu shqipton:

## **DËNIM ME GJOBË DHE ME KUSHT**

Të pandehurin e parë **Z. B.**, për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) vit nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën konform nenin 50 të KPRK-së dënimi me kusht do të revokohet, ku edhe do ti llogaritet koha e kaluar ne arrest shtëpiak prej datës 18.07.2023 deri me 03.08.2023.

Të pandehurin e dytë **F. B.**, për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve i cili

dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) vit nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën konform nenin 50 të KPRK-së dënimi me kusht do të revokohet, ku edhe do ti llogaritet koha e kaluar ne arrest shtëpiak prej datës 18.07.2023 deri me 03.08.2023.

Të pandehurin e tretë **P. B.** për veprën e parë penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) vit nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën konform nenin 50 të KPRK-së dënimi me kusht do të revokohet dhe për veprën e dytë penale Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së me dënim me gjobë në shum prej 700 euro.

Të pandehurin e katërt **A. B.**, për veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 (një) vit nuk kryen veprë tjetër penale, në të kundërtën konform nenin 50 të KPRK-së dënimi me kusht do të revokohet ku edhe do ti llogaritet koha e kaluar ne arrest shtëpiak prej datës 18.07.2023 deri me 03.08.2023.

Gjykata konform dispozisë 76 të KPRK-së të pandehurit të tretë **P. B.** i shqipton:

### **DËNIM UNIK ME KUSHT DHE ME GJOBË**

Të pandehurin e tretë **P. B.** për veprën e parë penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së dhe vepra penale Mbajtje në pronësi, kontroll, ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, i shqipton dënim me burgim prej 4 muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej 1 viti nëse i pandehuri nuk kryen veprë tjetër penale dhe me dënim me gjobë në shum prej 700 euro, të cilin dënim i pandehuri është e obliguar që ta paguaj në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Në rast se dënimi nuk realizohet as me detyrim, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësojë me dënim me burgim, konfrom nenit 43 par.3 të KPRK-së, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burg, të llogaritet shuma prej 20-€, ku edhe do ti llogaritet koha e kaluar ne arrest shtëpiak prej datës 18.07.2023 deri me 03.08.2023.

**E dëmtuara:** M. T. me vendbanim në fsh. S. K. L., udhëzohet që kërkesën pasuroro-juridike ta realizoj në procedurë të rregullt civile.

**DETYROHEN** të pandehurit që në emër të shpenzimeve të procedurës penale secili veç e veç kësaj gjykate t'ia paguajnë në emër të paushallit gjyqësor shumën nga 100-€, si dhe solidarisht ti paguajn shumën prej 50-€, në emër të shpenzimeve për ekspertiz mjeko-ligjore si dhe shumën prej 20 euro secili veç e veç në Fondin e Kompensimin e Viktimave të Krimit, të gjitha këto në afat prej 15 dite pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj PP.II.nr.4503/23 të dt.26.07.2023, i ka akuzuar të pandehurit Z. B. nga fsh. S. K. L., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me pikën 1.4 të KPRK-së, F. B. nga fsh. S. K. L., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me pikën 1.4 të KPRK-së, P. B. nga fsh.S. K.L., për shkak të veprave penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me pikën 1.4 të KPRK-së dhe veprës penale Mbajtje në pronësi, kontroll, posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, dhe A. B. nga fsh. S. K. L., për shkak të veprës penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 lidhur me pikën 1.4 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit në shqyrtimin fillestar është pajtuar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve për veprat penale për të cilat akuzohen, duke i propozuar gjykatës që të aprovohet

pranimi i fajësisë pasi që një pranim i till ka mbështetje në shkresat e lëndës dhe pas pranimit të fajësisë të njëjtit ti shpillet fajtor dhe ti dënoj sipas ligjit.

I pandehuri i parë Z. B. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndien vetin fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe ka shtuar se me të pandehurit tjerë jemi pajtuar, me të njëjtin janë familjar dhe se nuk do të kenë në të ardhmën asgjë të keqe, ato mosmarveshje pronësore do ti zgjidhin dhe ka shtuar se është i gjendjes së dobët ekonomike, mbajtës i familjes 5 anëtarsh, dhe e ka lutur gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehuri i dytë F. B. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndien vetin fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe njëherit ka shtuar se kjo ka ndodhur rastësisht sepse janë familjar me Z., të njëjtin e ka vëlla dhe ditën kritike i njëjti ka ardhur tek ne dhe për shkak të mosmarveshjeve ka ardhur deri te kjo, mirëpo ndihet i penduar kjo që ka ndodhur dhe janë pajtuar, ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehuri i tretë P. B. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndien vetin fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe pendohet për këtë që ka ndodhur, Z. e kanë mixh, ka kërkuar falje që ka ndodhur kjo dhe ka kërkuar nga gjykata që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

I pandehuri i katërt A. B. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se e ndien vetin fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet, jemi pajtuar me Z. – mixhën për qka ka kërkuar falje për këtë mosmarveshje, dhe e ka lutur gjykatën që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të pandehurit të tretë Jusuf Bytytqi av. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se bazuar në rrethanat në të cilat është kryer vepra penale si dhe faktin se fajsinë e ka pranuar i pandehuri, janë shumë të afërm mes veti, sinqeritetin e palëve e kryesisht të të akuzuarit P., ka propozuar që gjykata me raistin e matjes së dënimit ti shqiptoj një dënim sa më të lehtë me të cilën do të arrihet qëllimi i dënimit. Ndërsa sa i përket armës e cila i është gjetur P. ajo ka qenë me gas dhe se nuk është përdorur asnjëherë, në Gjermani nuk ka ndalesa dhe ka menduar se nuk ka pengesa pse e mbanë në shtëpi kjo që është gjetur me raistin e bastisjes së shtëpisë së tyre në emër të F. në fsh. S., duke konsideruar se me një dënim të arsyshëm duke i mar të gjitha faktet parasysht të arrihet qëllimi i ndëshkimit.

Mbrojtësi i të pandehurit të katërt Afrim Tasholli av. në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pas konsultave që ka pasur me të mbrojturin e tij, pas shpjegimit mbi benifitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë i njëjti me vullnetin e tij të plotë, pa presion nga askush e ka pranuar fajsinë, andaj e ka lutur gjykatën që të ketë parasysht rrethanat lehtësuese siç janë pendimi, kërkim falja, premtimi se nuk do të përsërisë asnjë veper penale dhe ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, dhe pas konsultimeve të mjaftushme me mbrojtësit e tyre këtu të pandehurit e tretë dhe të katërt, pranimi i fajit nuk është rezultat i forcës, kërcënimeve apo premtimeve, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk është e përfshirë në shkelje të qarta ligjore e as gabime faktike, konformë nenit 242 të KPPK-së, e pranoi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve për veprat penale për të cilën akuzohen.

#### *Matja dhe caktimi i dënimit*

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin e parë Z. B., gjykata pati parasysht të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, rrethanat personale dhe familjare pra, faktin se i njëjti është mbajtës i familjes 5 anëtarsh dhe i gjendjes jo të mirë ekonomike, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar thellësisht për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, si dhe fakti se është pajtuar me të akuzuarit e tjerë e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin pra, faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta

inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin e dytë F. B., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, është i moshës së vjetër, rrethanat personale dhe familjare pra faktin se i njëjti është mbajtës i familjes, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, si dhe fakti se është pajtuar me të akuzuarin e parë, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin e tretë P. B., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, është i moshës së re që lenë për të kuptuar se i njëjti në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishum i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, si dhe fakti se është pajtuar me të akuzuarit e parë, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 38 dhe 47 të KPRK-së.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin e katërt A. B., gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese konform nenit 69 të KPRK-së, ashtu që prej rrethanave lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat para kryerjes së veprës penale, pra faktin se i njëjti për herë të parë ka rënd ndesh me ligjin, është i moshës së re që lenë për të kuptuar se i njëjti në të ardhmen mund të bëhet anëtar i dobishëm i shoqërisë, sjelljen pas kryerjes së veprës penale pra, faktin se i njëjti është penduar për veprën penale dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsëritë sjellje të tilla, si dhe fakti se është pajtuar me të akuzuarit e parë, e veqanërisht pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethana rënduese gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale për të pandehurin pra faktin se në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i aftë për t'i kuptuar sjelljet dhe veprimet e veta inkriminuese dhe duke marr për bazë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, të njëjtit i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke qenë e bindur se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit konform nenit 47 të KPRK-së.

#### *Llogaritja e paraburgimit-arrestit shtëpiak*

Vendimi për llogaritjen e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar u bazua në nenin 79 të KPRK-së, pasi të pandehurit kanë qëndruar në masën e arrestit shtëpiak nga dt.18.07.2023 deri me dt.03.08.2023, respektivisht në kohëzgjatje prej 17 dite.

#### *Shpenzimet e procedurës*

Vendimi për shpenzimet e procedurës u bazua në nenin 449 dhe 450 të KPPK-së, ku gjykata i detyroj të akuzuarit secili veç e veç t'ia paguajn kësaj gjykate në emër të paushallit gjyqësor shumën nga 100 euro, dhe solidarisht t'ia paguajn shumën prej 50 euro në emër të shpenzimeve të procedurës penale për ekspertiz mjeko-ligjore, si dhe shumën nga 20-€, në

Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, kjo bazuar në nenin 36 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

*Kërkesa pasurore-juridike*

Vendimi për kërkesën pasurore-juridike u bazua në nenin 462 të KPPK-së dhe pala e dëmtuar u udhëzua që kërkesën pasurore juridike ta realizoj në procedurë të rregullt gjyqësore pasi që në këtë procedurë penale gjykata nuk ka mundur të vendos për kërkesën pasurore ngase nuk ka pasur dëshmi të mjaftueshme të cilat do ta vërtetojnë lartësinë e kërkesës.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe dispozitave të lartëpërmendura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË LIPJAN**  
**P.nr.369/23 dt.12.03.2024**

**Bashkëpunëtorja profesionale**  
**Gentiana Dakaj**

**GJYQTARI**  
**Avdirrahman Gashi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 30 dite nga dita e dorëzimit të të njëjtit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2023:157005  
Datë: 20.03.2024  
Numri i dokumentit: 05475200